



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Gjilanit  
Opština Gnjilane  
Municipal Gjilan  
Gilan Belediyesi

## DREJTORIA PËR GJEODEZI, KADASTËR DHE PRONË

Datë / Date	<b>24.12.2015</b>
PËR/TO:	Kryetarin e Komunës z.Lutfi Haziri
NGA/FROM:	DREJTORI I DGJKP- së Sadudin Berisha
TEMA / SUBJECT:	<b><i>RAPORTI I PUNËS PËR PERIUdhËN</i></b> Janar-Dhjetor 2015

I nderuari z.Kryetar,

Duke u bazuar në nenin 84, paragrafi 4 i Statutit të Komunës së Gjilanit, (01.nr.016-126211 i dt.06.11.2014), si dhe duke u bazuar në detyrat dhe përgjegjësit e drejtorisë, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, harton :

### RAPORTIN VJETOR

( Për periudhën Janar- Dhjetor 2015)

#### Fushëveprimtaria e drejtorisë:

Ofron shërbime profesionale dhe shërbime të tjera subjekteve të ndryshme. Është përgjegjëse për zhvillimin dhe organizimin e kapaciteteve kadastrale, rrjetën referuese homogjene, për sigurimin e hartave orto-foto, rikonstruimin e informatave kadastrale në formë digjitale, modelin e sistemit informativ mbi tokën dhe pronën. Sigurimi i zotërimit të tokës, reduktimin e kontesteve për tokën. Përmirësimin e transferimit të tokës, menaxhimi i tokës shtetërore dhe efikasiteti në taksimin e tokave. Planifikimi i rrjetit me pika të reja kontrolluese dhe themelimi i pikave të reja kontrolluese. Digjitalizimi i pikave poligonale dhe trigonometrike,

vektorizimi i planeve të skanuara (ngastrave dhe zonave kadastrale). Azhurnimi i pjesës grafike në bazë të dokumenteve dhe matjeve të reja dhe transformimi me parametrat e dhëna për transformim. Shërbimet e mirëmbajtjes së klasifikimit dhe kulturave të tokës. Ndarjen e ngastrave dhe shënimi i kufijve në rastin e eksproprijimit dhe kryen procedurat rreth eksproprijimit të tokës. Inspektimin e sipërfaqes së ndërtesave dhe përpunimi i skicave të ndarjeve për ndërtesa dhe banesa. Regjistrimin e pronës së paluajtshme dhe regjistrimin e tokës komunale. Zhvillon procedurat e regjistrimit sipas detyrës zyrtare dhe zhvillon procedurat e regjistrimit sipas kërkesës së palëve. Bënë korigjimin e regjistrimit sipas procedurave dhe zbaton të gjitha dispozitat pozitive në fuqi lidhur me regjistrimin e pronës.

Azhurnimi e pronës në bazë të dokumenteve të verifikuara dhe shënimeve të tjera nga dokumentacioni arkivor, azhurnimi i regjistrimit të ndërrimeve të mjeteve nga terreni.

Mbron pronën komunale - publike nga uzurpimet dhe udhëheq procedurat lidhur me këtë çështje. Bënë regjistrimin e ndërtesave kolektive dhe organizon mirëmbajtjen e pjesëve të përbashkëta të ndërtesave kolektive. Udhëheq me kadastrën etazh të banesave dhe menaxhon me banesat dhe objektet të tjera të komunës dhe mbanë evidencën për to, kryen procedurat për vërtetimin e transaksioneve dhe regjistrimin e tyre në librat etazh.

Ushtron kompetenca të tjera të parapara me ligj, të deleguara nga pushteti qendror.

### **Struktura organizative e drejtorisë:**

Për realizimin e përgjegjësive dhe detyrave të përshkruara si më lartë, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, është e organizuar në tre sektor :

- Sektori i Kadastrit,
- Sektori i Gjeodezisë,
- Sektori i Pronës.

Gjatë kësaj periudhe ( Janar- Dhjetor 2015 ) në DGJKP janë pranuar gjithsej **5303 lëndë-kërkesa** të ndryshme të qytetarëve dhe të personave juridik. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak , numri i lëndëve është rritur për **608** sosh.

Nr.	SEKTORI	Lëndë të pranuar		Lëndë të kryera		Në proced.	
		2014	2015	2014	2015	2014	2015
1.	<b>Sektori i Kadastrit</b>	<b>2610</b>	<b>3096</b>	<b>2583</b>	<b>3061</b>	<b>27</b>	<b>35</b>
2.	<b>Sektori i Gjeodezisë</b>	<b>670</b>	<b>684</b>	<b>652</b>	<b>660</b>	<b>18</b>	<b>24</b>
3.	<b>Sektori i Pronës</b>	<b>1415</b>	<b>1523</b>	<b>1396</b>	<b>1491</b>	<b>19</b>	<b>32</b>
	<b>TOTALI :</b>	<b>4695</b>	<b>5303</b>	<b>4631</b>	<b>5212</b>	<b>64</b>	<b>91</b>

Përveq kërkesave të paraqitura në tabelë, DGJKP ka kryer edhe punë dhe aktivitete tjera sipas detyrës zyrtare si dhe me kërkesa të Drejtorive Komunale, si në vijim :

1. Personat fizik dhe juridik si dhe institucionet e ndryshme, në DGJKP janë pajisur me **Certifikata të pronësisë (fleta poseduese), Kopje të planit, dhe Certifikata të gjendjes ekonomike, koordinata, etj.** Këtë aktivitet po e paraqesim në tabelën e mëposhtme :

Nr.r.	PRODUKTI	SASIA	
		2014	2015
1.	Certifikata të pronës / fleta poseduese	8942	11014
2.	Kopje të planit	2359	1893
3.	Koordinata të ngastrave	/	856
4.	Certifikata të gjendjes ekonomike	3667	2155
	Gjithsej :	<b>14968</b>	<b>15918</b>

2. DGJKP ka përgaditur lëndët dhe Propozim Vendimet të cilat janë shqyrtuar në Komitetin për Pronë, Komitetin për Politikë dhe Financa si dhe në Kuvendin Komunal. Vendimet e aprovuara në Kuvendin Komunal nga fushëveprimtaria e DGJKP-së, të gjitha janë konfirmuar nga ana e Ministrisë së Pushtetit Lokal si vendime të ligjshme dhe me efekt të plotë juridik, siç janë : Vendimet për këmbimin e pronës komunale me pronë private, Vendimet për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim personave fizik dhe juridik, në periudhë afatgjate dhe afatshkurtër.
3. Sa i përket procedurave të shpronësimit, gjatë vitit 2015, sipas Vendimeve Përfundimtare për nevoja të shpronësimit janë paguar **364.540,90 €** dhe janë në procedurë të regjistrimit 16 ngastra kadastrale nga pronarët privat në emër të komunës.

Për nevoja të hapjes së rrugëve sipas Planeve Rregulluese Urbane :

- “Fidanishte”**- Është hartuar Elaborati i Shpronësimit ku janë identifikuar pronarët e 103 ngastrave kadastrale, me sipërfaqe prej **1.78.93 ha** të nevojshme për rrugë. Janë përgaditur 100 ftesa për Debat publik me këta pronarë.
- “Kampi Montith”**- Është hartuar Elaborati i Shpronësimit ku janë identifikuar pronarët e 405 ngastrave kadastrale, me sipërfaqe prej **15.33.05 ha** të nevojshme për rrugë. Janë përgaditur 292 ftesa për Debat publik me këta pronarë.
- “Livadhet e Arapit”** - Është hartuar Elaborati i Shpronësimit ku janë identifikuar pronarët e 677 ngastrave kadastrale, me sipërfaqe prej mbi **14 ha** të nevojshme për rrugë.

**Nga të theksuarat si më lartë (pika : a, b dhe c ), shihet se me këto elabore janë përfshirë 1185 parcela kadastrale me sipërfaqe të nevojshme për rrugë prej 31.11.98 ha.**

4. Në DGJKP, gjatë vitit 2015 janë regjistruar në emër të Komunës së Gjilanit 5 parcela kadastrale me sipërfaqe të përgjithshme prej 1277 m<sup>2</sup>, të cilat pronarët me Deklarata me shkrim ia kanë falë komunës pa kurrfar kompenzimi për nevoja të rrugës publike. Katër ngastra gjinden në ZK Lladovë ( 825 m<sup>2</sup>) dhe njëra në ZK Bresalcë (452 m<sup>2</sup>).
5. Janë kryer shërbime të rindërtimit të të dhënave kadastrale dhe të matjeve për projekte zhvillimore, siç janë: Përgaditja e të dhënave kadastrale për rregullimin e mardhenjeve proësoro juridike të lagjës Dardania; përgaditja e të dhënave kadastrale për për fletën poseduese 3208 ZK- Gjilan ; Përpunim i shënimeve rruga e Prishtinës- Gjilan-Rruga Qarkore; Analiza e të dhënave Kadastrale të lagjës Dheu i Bardhë; korigjimi i të dhënave kadastrale

për objektj ish,, Soliter”; Shënimi i ngastrës kadastrale për Palestren Sportive në Zhegër; Shënimi i rrugës Mulliri Arapit- Zabel; Shënimi i rrugëve sipas Planit Rregullues në lagjen e Zabelit; Shënimi i rrugëve lokale në Livoq të Epërm; Shënimi i rrugës Preshevë- Gjilan deri në Velekincë; Verifikimi i uzurpimeve në rrugën Gjilan-Bujanoc; Verifikimi i uzurpimeve të rrugës Gjilan-Ferizaj; Shënimi i rrugëve lokale fushore Zhegër-Lladovë- Nosalë në gjatësi 2560 m; Shenimi i rrugëve lokale në fsh. Cërnice në gjatësi prej 3550m; shenimi i rrugëve lokale në fsh. Përlepnicë në gjatësi prej 2250m.

6. Jemi duke bërë përpjekje për sigurimin e hapsirave të nevojshme për lokacionin e ri të Varrezave të Qytetit të parapara sipas Planeve Zhvillimore Komunale dhe lidhur me këtë ju kemi drejtuar me kërkesë zyrtare Qeverisë së Kosovës dhe AKP-së për tërheqje nga procesi i privatizimit të disa pronave të Kombinatit Bujqësor të Gjilanit, dhe të njejtat t'i kthehen komunës
  
7. Duke u bazuar në përgjegjësit e Drejtorisë, DGJKP-ja sipas detyrës zyrtare ka ndërmarrë aksionin e rilevimit të objekteve komunale në tërë territorin e Komunës së Gjilanit. Ky aktivitet është ndërmarrë me qëllim të definimit të objekteve komunale, rregullimit të çështjeve pronësoreshme juridike të këtyre pronave në mënyrë që të bëhet regjistrimi i të njejtave në librat kadastral si prona komunale sipas destinimit të cilin e kanë. Rilevimi është duke u kryer sipas zonave kadastrale duke filluar nga zonat më të largëta e duke vazhduar në zonën kadastrale të qytetit. Deri më tani janë kryer matjet në këto Zona kadastrale, siç janë :

Nr.	Zona Kadastrale	Lloji i objektit	Lloji i objektit	Lloji i objektit	Lloji i objektit
1.	Bilinicë	Shkolla fillore			
2.	Stublinë	Shkolla fillore			
3.	Inatoc-Kokaj	Shkolla fillore			
4.	Sllubicë	Shkolla fillore			
5.	Pogragjë	Shkolla fillore	Zyra e vendit	Ambulanca	Fusha sportive
6.	LLovcë	Shkolla fillore			
7.	Uglarë	Shkolla fillore		Ambulanca	
8.	Bukovik-Capar	Shkolla fillore			
9.	Malishevë	Shkolla fillore	Zyra e vendit	Ambulanca	
10.	Stançiq	Ska objekt	Ska objekt	Ska objekt	Ska objekt
11.	Shurdhan	Shkolla në ndërtim	Zyra e vendit		
12.	Dunav	Objekti i shkollës jasht perdorimit			
13.	Pidiq	Objekti i shkollës jasht perdorimit			
14.	Haxhaj	Shkolla fillore			
15.	Selishtë	Shkolla fillore			
16.	Zhegër	Shkolla fillore e re			

Ky aktivitet është në proces dhe vazhdon në muajt e ardhshëm me zonat tjera kadastrale të Komunës së Gjilanit

**DGJKP-ja, gjatë kryerjes së këtyre punëve , ka krijuar edhe të hyra financiare të cilat në këtë periudhë kapin shumën prej 180.822, 00 €.**

Për fund, vlenë të theksohet se Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, gjatë kësaj periudhe ka patur bashkëpunim të ngushtë me Drejtoritë dhe Zyret tjera komunale, me institucionet dhe agjencitë qeveritare : MAPL-në, Ministrinë e Financave, Agjencionin Kadastral të Kosovës, Agjencionin Kosovar të Privatizimit, Agjencionin Kosovar të Pronave, Agjencinë Pyjore të Kosovës, Arkivin Historik Ndërkomunal në Gjilan, Gjykatat e rangut të ndryshëm etj. Si dhe me Organizatat ndërkombtare të cilat veprojnë në Kosovë : OSCE, USAID, KFOR etj.

Gjilan, 24.12.2015

Drejtori i DGJKP-së

---

/Sadudin BERISHA/